



Mensa e studentëve, kati i parë
Prishtinë, 10000, **Kosovë**
Nr. Fiskal 600171350
SPP: 6001163-0

[Tel: \(+383\) 38 224 498](tel:+38338224498)
[Fax: \(+383\) 38 224 498](tel:+38338224498)
[Web: www.birn.eu.com](http://www.birn.eu.com)
[E-mail: kosova@birn.eu.com](mailto:kosova@birn.eu.com)

PASQYRAT FINANCIARE MË 31 DHJETOR 2019

1. Të përgjithshme

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese ("BIRN") është Organizata jo qeveritare, jo fitim prurëse, me status të benificuar publik, e regjistruar në Ministrinë e Shërbimeve Publike, Departamenti i regjistrimit dhe Ndërlidhjes së OJQ-ve.

Numri i regjistrimit të organizatës 5110121-4, numri fiskal është 600171350 dhe numri i statusit të benificuar publik është 6001163-0

Selia e Organizatës është në "Mensa e Studentëve, Kati I, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Misioni i organizatës:

BIRN është themeluar me qëllim të forcimit të kapaciteteve hulumtuese në Kosovë dhe më gjerë. Për t'i përmbushur qëllimet e saj, BIRN ndërmerr por nuk kufizohet vetëm në aktivitetet e poshtë-shënuara:

- Gazetari Hulumtuese në shtyp, online dhe media transmetuese;
- Trajnime gazetareske;
- Produksion Televiziv;
- Monitorim të institucioneve publike;

BIRN është themeluar me qëllim të forcimit të kapaciteteve hulumtuese në Kosovë dhe më gjerë.

2. Bazat e paraqitjes

Pasqyrat financiare shprehen në euro (valute zyrtare në Kosovë) dhe paraqiten në një format që përputhen me standardet e kërkuara nga Standardet të Kontabilitetit Kosovare dhe atë Ndërkombëtar.

3. Përmbledhja e politikave kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

3.1. Paraja dhe vlera arke e të tjera

Paraja dhe vlera arke e të tjera përfshin shumën me para në dorë me një matarim fillestar prej tre ose me pak muajsh.

3.2. Kërkesat për arkëtim mbi debitorët

Kërkesat për arkëtim mbi debitorët janë shprehur në vlerën e realizueshme neto të tyre.

3.3. Prona, impiantet dhe pajisjet

Zhvlerësimi në pronë, impiante dhe pajisje llogaritet me metodën e zhvlerësimit drejtvizor (linear), dhe janë të ndara në kategori të ndryshme duke u bazuar në politikat lokale dhe në llojin e mjetit.

Normat vjetore të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Kategoria 1.-Ndërtesat dhe strukturat e ndërtimit	5%
Kategoria 2.-Pajisjet dhe investimet ne zyre me qira	20%
Kategoria 3.-Pajisjet e rënda	10%

3.4. Furnitorët për blerje dhe shërbime

Furnitorët për blerje dhe shërbime shprehen në vlerën e tyre nominale.

3.5. Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat nga grantet

(i) Këstet apo arkëtimet e pranuar për grantet të lidhura për blerjen e pajisjeve, apo të lidhura me rimbursimin e shpenzimeve (të tashme apo të me të ardhmen) paraqiten fillimisht si të ardhura të shtyra në "Pasqyrën e pozitës financiare", dhe sistematikisht njihen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhave përkatëse në raport me shpenzimet e lidhura me to, apo kostot e shoqëruara që mbulojnë nga granti dhe që duhen të kompensohen.

(ii) Arkëtimet e pranuar për grantet të lidhura me shpenzimet ose humbjet tashmë të shkaktuara, apo për mbështetje të menjëhershme financiare (pa shpenzime të lidhura me të ardhmen), njihen si e ardhur "në pasqyrën e ardhurave gjithë përfshirëse" në periudhën në të cilën granti është i arkëtueshëm.

Shpenzimet

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në bazë akruale kur kanë ndodhur.

3.6. Tatimi në Fitim

Shpenzimi tatimor për periudhën llogariten në bazë të ligjeve tatimore në fuqi me normë 10%. Organizata nuk i nënshtrohet tatimit në fitim.

3.7. Fondet (neto pasuria)

Fondet e Organizatës janë të ndarë në mes të Fondeve kapitale, Fondeve operative, dhe Fondeve të përcaktuara apo ndryshe të quajtur "Fondi i kufizuara".

(i) Fondet kapitale

Fondet kapitale paraqesin impiantet, objektet dhe pajisjet fikse të organizatës. Të gjitha lëvizjet në pasuritë fikse kontabilizohen përmes këtij fondi (blerjet, heqjet nga përdorimi, amortizimin, rivlerësimet, etj).

(ii) Fondet operative

Fondet Operative, gjithashtu quhen "Fondet e pa-kufizuara," dhe tregojnë burimet në dispozicion të organizatës për operacionet e saj, duke përfshirë para të gatshme dhe pasuritë e tjera aktuale.

(iii) Fondet e përcaktuara ose të kufizuara

Fondet e përcaktuara, gjithashtu quhen "Fondet e kufizuara," janë burime që janë të destinuara për qëllime specifike dhe pa miratimin specifik të dhuruesit (apo subjektit që e ka imponuar kufizimin) nuk mund të përdoren për funksionimin e përgjithshëm të organizatës. Shumë dhurues japin fonde për qëllime dhe aktivitete të veçanta ose në përputhje me rregulloret ose kufizimet e veçanta. Këto fonde të veçanta organizata pranuese nuk mund të përzier me fondet e tjera apo të shpenzojnë në ndonjë mënyrë tjetër se nga qëllimi i imponuar. Në disa raste, organizatës mund të kërkohet të mbajnë libra specifike të llogarisë, të ndarë nga sistemi i përgjithshëm i kontabilitetit financiar të organizatës, për të regjistruar të gjitha burimet dhe përdorimet e parave të kufizuara, detyrimet e lidhura, pasuritë, bilancet dhe shumatat e mbetura për të lejuar donatorit monitorimin e vazhdueshëm mbi pajtueshmërinë. Dështimet për mbajtjen e evidencave të tilla në pajtim me kufizimet dhe kushtet e përcaktuara mund të qojnë në ndërprerjen e financimit.

Fondet operative dhe fondet e përcaktuara kryesisht janë dhurime me fonde monetare dhe mbahen në zërin e veçantë në Pasqyrën e pozitës financiare në grupin e Fondeve qarkulluese .

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese ("BIRN")

BILANCI I GJENDJES - Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (Euro)

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
PASURITË		
<i>Pasuritë Qarkulluese</i>		
· Paratë në bankë dhe në arkë	805,604	800,118
· Të arkëtueshmet nga grantet	406,580	503,776
· Shpenzimet e parapaguara	133,340	95,514
Totali pasuritë qarkulluese	<u>1,345,524</u>	<u>1,399,409</u>
<i>Pasuritë Joqarkulluese</i>		
· Pajisjet dhe makineria	105,714	30,899
Totali pasuritë joqarkulluese	<u>105,714</u>	<u>30,899</u>
GJITHSEJ PASURIA	1,451,238	1,430,308
DETYRIMET DHE NETO PASURITË (fondet)		
<i>Detyrimet</i>		
· Të pagueshmet tregtare	40,348	3,384
· Detyrimet ndaj taksave dhe rrogave	408	0
Totali i detyrimeve	<u>40,756</u>	<u>3,384</u>
<i>Neto pasurit (fondet)</i>		
· Fondet qarkulluese	1,305,177	1,396,025
· Fondet kapitale	105,714	30,899
Totali neto pasurit (fondet)	<u>1,410,890</u>	<u>1,426,925</u>
GJITHSEJ DETYRIMET DHE NETO PASURITË (fondet)	1,451,646	1,430,308

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese ("BIRN")

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMET - Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (Euro)

	Fondet		2019	2018
	Programore	Kapitale	TOTALI	TOTALI
<i>Të ardhurat bruto lidhur me aktivitetet operative:</i>				
Të ardhurat nga Grantet	1,481,268	(74,814)	1,406,453	911,973
Të ardhurat nga veprimtaria ekonomike	-	-	-	-
Totali të ardhurat bruto	1,481,268	(74,814)	1,406,453	911,973
<i>Shpenzimet e lidhura me aktivitetet operative:</i>				
Pagat bruto dhe Pagat për Shërbime	(738,003)	-	(738,003)	(526,115)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	(636,934)	-	(636,934)	(362,467)
Shpenzimet për zhvlerësim dhe amortizim	-	(31,516)	(31,516)	(23,391)
Shpenzimet tjera operative (blerje pajisje)	(106,331)	106,331	-	-
Totali i shpenzimeve operative	(1,481,268)	74,814	(1,406,453)	(911,973)
Fitimi (humbja) nga aktivitetet operative	-	-	-	-
<i>Aktivitetet jo-operative</i>				
Të ardhurat tjera	-	-	-	-
Shpenzimet tjera	-	-	-	-
Fitimi (humbja) nga aktivitetet jo-operative	-	-	-	-
Të ardhurat neto ose humbja para tatimi	-	-	-	-
Tatimi në të Ardhurat e Korporatave	-	-	-	-
TË ARDHURAT NETO OSE HUMBJA PAS TATIMI	-	-	-	-

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHË PËRFSHIRËSE - Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019(Euro)

	Fondet		2019	2018
	Programore	Kapitale	TOTALI	TOTALI
<i>Suficiti/deficiti i periudhës</i>				
Të ardhurat neto ose humbja pas tatimi	-	-	-	-
Rritje e pasurive afatgjata	-	106,331	106,331	12,445
Zhvlerësimi	-	(31,516)	(31,516)	(23,391)
SUFICITI APO (DEFICITI) PËR PERIUdhËN	-	74,814	74,814	(10,946)

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese ("BIRN")

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË - Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në Euro)

	2019	2018
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</i>		
· Fitimi-suficiti apo (Humbja-deficiti) për periudhën rregullimet:	74,814	(10,946)
· Zhvlerësimi dhe amortizimi	0	
· Rritje/zvogëlim në parapagimet	31,516	23,391
· Rritje/zvogëlim në të arkëtueshmet nga grantet	0	0
· Rritje/zvogëlim në të pagueshmet	97,196	83,821
· Rritje/zvogëlim llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	36,964	3,384
· Avanset e dhëna per Subgrante dhe Partnerëve të projekteve	93	(93)
· Rritje/zvogëlim ne fondet qarkulluese të projekteve	(37,918)	(80,266)
	(90,849)	92,848
Paraja neto nga aktiviteti operativ	111,817	112,139
 <i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</i>		
· Rritje/zvogëlim në pasuri fikse	(106,331)	(12,445)
Paraja neto nga aktiviteti investues	(106,331)	(12,445)
 <i>Rritja/Zvogëlimi neto e parasë së gatshme</i>	5,486	99,694
· Paraja në fillim të periudhës	800,118	700,424
TOTALI I PARASË NË FUND TË PERIUdhËS	805,605	800,118

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese ("BIRN")

PASQYRA E LËVIZJES SË FONDEVE (NETO PASURITË) - Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019
(në Euro)

	<i>Fondet qarkulluese (programore)</i>	<i>Fondet Kapitale</i>	<i>Fitimet e mbajtura (ekonomike)</i>	<i>TOTALI</i>
<i>Neto pasuritë (fondet) 2019</i>				
Gjendja 1 Janar	1,399,408	30,900	0	1,430,308
Shtesat gjatë vitit	1,321,053	106,331	0	1,427,383
Shpenzimet e vitit	(1,374,937)	(31,516)	0	(1,406,453)
<i>Gjendja 31 Dhjetor 2019</i>	1,345,524	105,714	0	1,451,238
<i>Neto pasuritë (fondet) 2018</i>				
Gjendja 1 Janar	1,303,177	41,846	0	1,345,024
Shtesat gjatë vitit	984,813	12,445	0	997,258
Shpenzimet e vitit	(888,582)	(23,391)	0	(911,973)
<i>Gjendja 31 Dhjetor 2018</i>	1,399,408	30,900	0	1,430,308
<i>Gjendja 31 Dhjetor 2017</i>	1,303,177	41,846	0	1,345,024